



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIKE DHE INVESTIMEVE**

Elbasan, më . . .2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Rinovim licensa Firewall dhe EDR antivirus (1vit) ”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – sherbim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 48000000-8 – Paketa software dhe sisteme informacioni

VLERA E FONDIT LIMIT - 2,000,000 (dymilion) lekë pa tvsh

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 9;

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik,

nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10**;

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

b) Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardeve ISO:

a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit

Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi 2.3.2/a, 2.3.2/b:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të

argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Çertifikimet ISO, janë çertifikata që i'u akordohen kompanive/organizatave të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Argumentimi për kërkesë për paraqitjen e Çertifikimit ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Argumentimi për kërkesën për paraqitjen e Çertifikimit ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit; Është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon Autoriteti Kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- Respektimin e kërkesave rregullatore në lidhje me sigurinë e informacionit, gjë që mund të zvogëlojë rrezikun e veprimeve jo ligjore.
- Identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë e informacionit, gjë që siguron që ofertuesi i shërbimeve/mallarave T.I.K, të shmangin rreziqet e mundshme dhe të përmirësojnë qëndrueshmërinë e përgjithshme të sistemit.
- Eliminonjë proceset e panevojshme, të reduktojnë gabimet dhe të përmirësojnë performancën e përgjithshme, duke çuar në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit.

Në kushtet që instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme të sistemit, kërkon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit, si rrjedhojë çertifikimi ISO 27001, është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen. Të gjitha të dhënat që do të trajtohen dhe do të ruhen në sistem, përfshirë edhe ato të konfigurimit si dhe të përdoruesve të sistemit janë të ndjeshme. Akses

në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit dhe aksesit në informacion për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi monitorues i kontratës, megjithatë çertifikimi ISO 27001 për operatorin ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për ofrimin e shërbimit të rinovimit të Licensave. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike, bazuar ne nenin 77/2 te LPP: *Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim, në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Shërbimet e rinovimit të kërkuara përfshijnë dhe shërbime të mirëmbajtjes të teknologjisë standarde Fortinet në të cilën janë implementuar pajisjet Firewall, rrjedhimisht është e domosdoshme që operatori fitues të jetë i autorizuar për lëvrimin e këtij rinovimi nga prodhuesi apo nga të tjerë të autorizuar nga prodhuesi për këtë.

Posedimi i autorizimit nga prodhuesi garanton që ofruesi i shërbimit është i trajnuar dhe i certifikuar nga prodhuesi për të kryer nderhyrjet e nevojshme. Kjo rrit sigurinë që shërbimi do të kryhet sipas specifikave dhe standardeve të prodhuesit, duke minimizuar mundësinë e gabimeve ose problemeve teknike. Operatoreve të autorizuar nga prodhuesi u jepet qasje direkte në mbështetjen teknike nga prodhuesi. Kjo siguron që sistemi të jetë plotësisht i mbrojtur nga dobësitë e njohura të sigurisë. Shumë prodhues kushtëzojnë që nderhyrjet teknike në sistem të kryhen vetëm nga kompani të autorizuar. Subjektet e autorizuar nga prodhuesi kanë një nivel të lartë njohurish teknike dhe përvojë të drejtpërdrejtë me produktet specifike të sistemit. Sistemi përfshin të dhëna sensitive, është thelbësor që mirëmbajtja të kryhet nga subjekte të besuar, të cilët janë të njohur për praktikën e tyre të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Autorizimi nga prodhuesi është një siguri se këta operatore ndjekin protokollet e rekomanduara dhe të rrepta të sigurisë. Kjo siguron që mirëmbajtja dhe suporti të kryhet me komponentët dhe softuerin e certifikuar nga prodhuesi, duke garantuar qëndrueshmëri dhe përputhshmëri të plotë me sistemin ekzistues. Autorizimi nga prodhuesi garanton që ofertuesi i shërbimeve ka qasje në njohuri specifike të sistemit, duke u aftësuar për të optimizuar performancën e tij dhe për të zgjidhur probleme komplekse që mund të hasen. Ky nivel ekspertize minimizon rreziqet e ndonjë defekti. Ofruesit e autorizuar kanë përvojë të provuar me ndërprerje minimale të operacioneve të përditshme. Kjo ndihmon në mbajtjen e proceseve të vazhdueshme dhe në shmangien e rrezikut të dështimit të sistemit

2.3.4. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë shërbimin e kërkuar, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës të certifikuar për ITIL menaxhimin e shërbimeve IT/ ekuivalente.
- 1 (një) profesionist të certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit.
- 1 (nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi për implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për Endpoint EDR te ofertuar ose ekuivalente.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse në DST.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

[..Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se Operatorët Ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie..]

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se objekt-prokurimi është një projekt i teknologjisë së informacionit (T.I.K) nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar ose/dhe të certifikuar në fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

1 (nje) punonjës të certifikuar për ITIL menaxhimin e shërbimeve IT/ ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar .Angazhimi i një punonjësi të certifikuar si certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT sipas standardit ITIL (ose ekuivalent) është thelbësore, për të garantuar funksionimin efektiv, të qëndrueshëm dhe të standardizuar të shërbimeve teknologjike të përfshira. Një profesionist i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve IT ka aftësinë për të dizenuar dhe vendosur në funksion procese që optimizojnë performancën dhe cilësinë e shërbimeve IT. Një punonjës i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve

IT ofron garanci se ofrimi, mbështetja dhe rikuperimi i shërbimeve IT do të menaxhohen me profesionalizëm dhe sipas praktikave më të mira të njohura ndërkombëtarisht. Kjo jo vetëm që përmbush kërkesat teknike të projektit, por siguron gjithashtu një kulturë të qëndrueshme të menaxhimit të shërbimeve, e cila është e nevojshme për të përballuar sfidat e operimit të përditshëm dhe emergjencave teknologjike.

1 (një) profesionist të certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit.

Argumentim: Kërkesa për të angazhuar një profesionist të certifikuar për sigurinë e sistemeve të informacionit është përcaktuar në përputhje me Vendimin Nr. 945, datë 2.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore’”. Profesionisti, ndër të tjera, do të sigurojë që të gjitha të dhënat personale dhe financiare të përdoruesve të ruhen dhe të përpunohen në mënyrë të sigurt, duke përfshirë enkriptimin dhe autentifikimin e duhur. Gjithashtu, profesionisti i certifikuar për sigurinë do të integrojë modulet e reja në platformën ekzistuese pa kompromentuar sigurinë e sistemeve dhe do të sigurojë që të gjitha pikat e hyrjes janë të mbrojtura. Kjo kërkesë ofron garanci për Autoritetin Kontraktor (AK) se OE është i aftë të identifikojë dhe adresojë problemet e mundshme të sigurisë që mund të rezultojnë në humbje të të dhënave. Certifikimi për sigurinë e sistemeve të informacionit dëshmon se punonjësi është i kualifikuar për të hartuar dhe zbatuar politika të ndryshme të sigurisë, përfshirë politikat e aksesit të të dhënave, politikat e kontrollit të versionit dhe politikat e mirëmbajtjes së të dhënave. Gjithashtu, ai/ajo do të krijojë dhe implementojë politika të sigurisë së informacionit, duke siguruar që sistemi të jetë i mbrojtur ndaj sulmeve të mundshme.

1 (një) punonjes te certifikuar nga prodhuesi për implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për Endpoint EDR te ofertuar ose ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Specialistët e certifikuar për Endpoint **EDR te ofertuar ose ekuivalente** të zotërojnë ekspertizën për të dizenuar, konfiguruar dhe optimizuar zgjidhjet EDR sipas praktikave më të mira dhe arkitekturës së sistemit përkatës. Specialistët e certifikuar do të jenë përgjegjës për ndërtimin e këtyre politikave, përcaktimin e rregullave për klasifikimin e të dhënave, menaxhimin e alarmeve, si dhe koordinimin me administratorët e rrjetit dhe të endpoint-eve për të siguruar ndërveprimin me platformat mbrojtëse të tjera si firewalls.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Çertifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vëndi i origjinës, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.
- CV e secilit punonjës.

- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Argumentim: Kërkesa për staf sipas kërkesave të kriterit 2.3.3 është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4, ku citohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën).

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga strukturat e AK në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT